



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 338/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vodosur përkitazi me ankesën e Jelena Stojanoviç – Drejtoreshë e Shërbimeve Komunale në Graçanicë, paraqitur kundër Subjekteve politike për shkak të vendosjes së posterëve në vende dhe rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet poshtë si e pa rregullt ankesa e Jelena Stojanoviç – Drejtoresh e Shërbimeve Komunale në Graçanicë .

Arsyetim

Me datën 24.10.2013, Jelena Stojanoviç, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, infrastruktura në komunën e Graçanicës është në gjendje shumë të keqe për shkak të vendosjes së posterëve nëpër shenjat e trafikut të cilët disa herë janë rrëzuar, për shkak të vendosjes së posterëve në objektet publike dhe godinat publike . Më tutje ka shtuar se pas shkresës sime të parë në PZAP dhe pas intervenimit të punëtorëve në teren gjendja nuk është ndryshuar, ku me datë 23.10.2013 i gjithë vendi në fshatin Livagjë ka qenë i mbuluar me posterë nëpër shenja të trafikut, në gardhet e parqeve, transformatorët e rrymës dhe në kutitë e ndriçimit, veprime këto të kryera nga subjektet politike dhe simpatizuesit e tyre që nuk i rrepsketojnë Kodin e Mirësjelljes në një mënyrë të tolerancës demokratike.

Për më tepër ka kërkuar nga PZAP-i, që të reagojë në bazë të shkresës së parë dhe atë të dytë në përputhje me ligjin. Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se është shkelur neni 33 i ligjit me nr. 003/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar 40 fotografi si dëshmi .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pa rregullt

Me ankesën e parashtruar nga Jelena Stojanović, pretendohet se në komunën e Graçanicës është dëmtuar prona komunale, pra infrastruktura rrugore është në gjendje shumë të keqe për shkak të vendosjes së posterëve nëpër shenjat e trafikut të cilët disa herë janë rrëzuar, për shkak të vendosjes së posterëve në objektet publike dhe godinat publike dhe krejt këto veprime janë të kryera nga subjektet politike dhe simpatizantët e tyre, mirëpo parashtruesi i ankesës nuk e ka precizuar saktësisht në ankesën e ushtruar se kush është shkelësi i supozuar dhe nga kush janë shkaktuar veprimet e ndaluara.

PZAP-i konstatoi se një pretendim i tilë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu shqyrtuar, prandaj ankesa vlerësohet si e parregulltë bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendor u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë

A nr. 338/2013 më datën 25.10.2013



Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Nehat Idrizi", is written over the typed name "Nehat Idrizi".

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.